



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 27
Prishtinë, më 29 korrik 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29 KORRIK 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komisionin e pavarur të mediave,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për partneritet publiko privat,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transmetimin publik në Kosovë,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin funksionit publik,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmën shtetërore,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për verërat,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmën juridike falas

11. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010,
12. Propozimi i GP të PDK-së për emërimin e anëtarit në Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komunisteve dhe për Kthim,
13. Propozimi i GP të SLS-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
14. Propozimi i GP të Koalicionit Kosova e Re për emërimin e anëtarit në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komisionin e pavarur të mediave

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për Komisionin e pavarur të mediave.

Zv. kryeministri, **Hajredin Kuçi**, tha se arsyet e hartimit të këtij Projektligji qëndrojnë në realizimin e objektivit për nxitjen dhe mbajtjen e një sistemi të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve të mediave audiovizuale dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet evropiane. Në vazhdim, Zv. kryeministri theksoi se ky Projektligj adreson çështjet që kanë të bëjnë me profesionalizimin e shërbimeve mediale audiovizuale duke mbështetur dhe përkrahur lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audiovizuale. Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për Komisionin e pavarur të mediave.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputeti, Idriz Vehapi, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Xhevahire Izmaqi, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Jeton Svirca, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Rasim Demiri, si dhe deputetja Blerta Deliu-Kodra, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Komisionin e pavarur të mediave.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për partneritet publiko privat

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për partneritet publiko privat.

Ministri, **Bedri Hamza**, tha se arsyeja e nxjerrjes së këtij Projektligji është avancimi dhe konsolidimi i bazës ligjore që ka të bëjë me partneritet publiko private.

Në vazhdim, ministri theksoi se ky Projektligj do të rregullojë partneritet publiko private për ofrimin e shërbimeve publike ose infrastrukturës publike në të gjithë sektorët ekonomik dhe shoqëror, duke përfshirë për pa u kufizuar në: transport, infrastrukturë energjetike, naftësjellësit, gazsjellësit, administrimin e ujit, ujërave të zeza, ujitjes, riciklimi i mbeturinave, telekomunikacioni, arsimi, shëndetësia, turizmi, sporti dhe rekreacioni etj.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për partneritet publiko privat.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja, Safete Hadergjonaj, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Duda Balje, si dhe deputetja Justina Shiroka-Pula, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 71,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për partneritet publiko privat..

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transmetimin publik në Kosovë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për transmetimin publik në Kosovë.

Ministri, **Bedri Hamza**, tha se nevoja për nxjerrjen e këtij ligji konsiston në rregullimin, themelimin, funksionimin dhe kompetencat e transmetuesit publik të Kosovës, me qëllim të sigurimit të informimit të saktë, objektiv, të paanshëm dhe të shpejtë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, ministri theksoi se ky Projektligj adreson çështjet që kanë të bëjnë me objektivat, veprimtarinë dhe parimet programore të transmetuesit publik siç janë:

sigurimi i transmetimit të programeve me standarde të larta profesionale, informimi i dëgjuesve-shikuesve me paanësi të plotë, etj.

Për zhvillimin e veprimtarisë dhe aktivitetet e tij ligjore, RTK, financohet nga parapagimi, themeluesi, nga vetëfinancimi dhe nga burime të tjera, theksoi ministri.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për transmetimin publik në Kosovë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputeti, Idriz Vehapi, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Xhevahire Izmaku, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Jeton Svirca, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Enis Kervan, si dhe deputetët: Blerta Deliu-Kodra, Safete Hadergjona, Alma Lama dhe Donika Kadaj-Bujupi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 68,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për transmetimin publik në Kosovë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Deputeti, **Sabri Hamiti**, propozoi që për pikat nr. 4. dhe 5. të rendit të ditës, Kuvendi të deklarohet me votim për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit.

Kryesuesi, kërkoi nga deputetët deklarimin me votim lidhur me propozimin e deputetit, Sabri Hamiti për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit.

Kryesuesi, konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin e deputetit Hamiti për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit, për pikat nr. 4. dhe 5. të rendit të ditës.

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ministri, **Bedri Hamza**, fillimisht tha se në Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i cili është në fuqi, janë evidentuar zbrastësira juridike dhe mangësi të cilat kanë krijuar probleme drejt parandalimit të konfliktit të interesit. Nisur nga ky fakt është paraqitur nevoja e hartimit të Projektligjit të ri, në mënyrë që të vendosen dispozita të reja në këtë fushë me qëllim të rregullimit më të mirë dhe më të qartë të këtyre dispozitave.

Në vazhdim, ministri theksoi se ky Projektligj adreson çështjet që kanë të bëjnë me ushtrimin e dy funksioneve në të njëjtën kohë në sektorin publik, me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik, sanksionet e parapara për shkeljet e dispozitave të këtij Projektligji, dhe është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Halit Krasniqi, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Haki Demolli, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Myfera Shinik, si dhe deputeti, Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65,

Kundër----- 1,

Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Ministri, **Bedri Hamza**, tha se ky Projektligj përcakton detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë për ta deklaruar pasurinë, të hyrat dhe prejardhjen, detyrën e Agjencisë për ta kontrolluar deklarimin dhe kontrollin e pasurisë si dhe detyrimet e të gjithë personave zyrtarë për të deklaruar dhuratat dhe prejardhjen e tyre.

Në vazhdim, ministri theksoi se ky Projektligj rregullon edhe procedurën e deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, si dhe sanksionet e përcaktuara.

Ky Ligj nuk do të ketë kosto financiare dhe nuk parasheh dispozita organizative dhe funksionale me të cilat do të kishte ndikim financiar në buxhetin e vendit, theksoi ministri.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Nijazi Idrizi dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmën shtetërore

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndihmën shtetërore.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, dhe amendamentin nr. 9. Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndihmën shtetërore.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Arben Gashi.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Gashi, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, dhe amendamentin nr. 19.
mbrojtjen e dëshmitarëve.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani, Ardian Gjini, Sabri Hamiti, Arsim Bajrami dhe Alma Lama. Këto diskutime janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 54,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për verërat

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për verërat.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, dhe amendamentin nr. 6.
Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 02/L – 8 për verërat.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka kërkuar nga Kuvendi afat shtesë për paraqitjen e Raportit në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputeti, Agim Kuleta. Ky diskutim është paraqitur në mënyrë të plotë në transkript.

Kryesuesi hodhi në votim kërkesën e Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, i lejohet afati shtesë, për paraqitjen e Raportit në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe prestatarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmën juridike falas

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndihmën juridike falas.

Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Arben Gashi.

Deputetja, Safete Hadergjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa propozoi që shqyrtimi i dytë i këtij Projektligji të shtyhet, me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve lidhur me implikimet buxhetore.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputeti, Sabri Hamiti. Ky diskutim është paraqitur në mënyrë të plotë në transkript.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e deputetes Safete Hadergjonaj për shtyrjen e shqyrtimit të dytë të këtij Projektligji.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

1. Shtyhet shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmën juridike falas.
2. Ngarkohet Komisioni funksional për Legjislacion dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, që në konsultim me propozuesin-Qeverinë e Republikës së Kosovës, t'i

harmonizojnë qëndrimet lidhur me implikimet buxhetore të Projektligjit për ndihmën juridike falas dhe Kuvendit t’ia paraqesin Raportin me rekomandime.

11. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010

Deputeti, **Ali Sadriu**, në emër të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin në mbledhje plenare, bashkë me rekomandimet e ofruara.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ali Sadriu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bali Muharremaj, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Sevdije Lama, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	62,
Kundër-----	1,
Abstenime-----	1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

I. Miratohen rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010, si në vijim:

1. Radiotelevizioni i Kosovës në afatin prej tre muajve, të ndërmarrë veprime konkrete lidhur me të gjitha të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe lidhur me këtë ta njoftojë Kuvendin, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike me raport me shkrim.
2. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të bëjë një auditim të performancës së RTK-së.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, do të angazhohet që t’i mundësojë Radiotelevizionit të Kosovës mbulimin me sinjal në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

12. Propozimi i GP të PDK-së për emërimin e anëtarit në Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

Kryesuesi, i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i PDK-së, akoma nuk ka propozuar emërimin e anëtarit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

Kryesuesi, konstatoi se kjo pikë shtyhet për mbledhjen tjetër.

13. Propozimi i GP të SLS-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Kryesuesi, i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar SLS, ka propozuar zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

Ai kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar të SLS.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Deputeti, Milivoje Stojanoviç, nga Grupi Parlamentar SLS, emërohet anëtar i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në vend të deputetit, Vesimir Saviç.

14. Propozimi i GP të Koalicionit Kosova e Re për emërimin e anëtarit në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re, ka propozuar emërimin e anëtarit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Ai kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Deputeti, Emin Gërbeshi, nga Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re, emërohet anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës, në vend të ish deputetit, Ibrahim Makolli.

Në fund, kryesuesi i njoftoi se pushimi i Kuvendit është nga data 1 gusht deri më 20 gusht 2011.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për çështje plenare dhe procedurale